



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 20/10/2022 Ref.: 1778/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018, datë 28.09.2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 105-të mbajtur më 04.10.2022 mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programei i studimit i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, për periudhën tre (3) vjeçare, 1 tetor 2022 - 30 shtator 2025:
 1. *Teknologji Ushqimore, BSc 180 ECTS*. Maksimumi 60 studentë për vit akademik.
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” që çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë mbanë përgjegjësi ligjore për moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti “Haxhi Zeka” në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditim të programit të studimit me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Teknologji Ushqimore, BSc 180 ECTS Riakreditim	Arsim Elshani Ibrahim Hoxha Arjeta Camaj Ibrahim

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA me datë 26.08.2022 ka organizuar vizitë në Universitetin “Haxhi Zeka” në Pejë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Kyriaki Zinovidou dhe Juraj Bogat.

Bazuar në nenin 17 të Udhëzimit Administrativ MASHT (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për programin në fjalë, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Teknologji Ushqimore, BSc 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht një (1).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 105-të të mbajtur më 04.10.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Hazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

